



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 535/1 Prot.

Tiranë, më 31.03.2026

V E N D I M

Nr. 72, Datë 31.03.2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 74 Regj., datë 11.03.2026, paraqitur nga z. N.T., (në vijim ankuesi) kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi z. Nikoll Tanushi parashton se:

“Unë, N. T., paraqes këtë ankesë ndaj Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për shkak të mosveprimit dhe zvarritjes së trajtimit të çështjes sime, duke sjellë pasoja të rënda dhe duke cënuar të drejtat e mia si person me aftësi të kufizuara.

Pranë banesës sime në fshatin Ishull Lezhë, kalon një kanal kullues me përmasa të konsiderueshme. Me kalimin e viteve, mbi këtë kanal janë kryer ndërtime pa leje, të cilat pengojnë rrjedhjen normale të ujit. Për shkak të kësaj shtate, sa herë ka reshje të dendura shiu, uji del nga kanali dhe përmyt tokën dhe banesën time, duke shkaktuar dëme materiale dhe vështirësi serioze në jetën e përditshme. Çështja ka filluar që në vitin 2008, kur kam paraqitur ankesa pranë institucioneve kompetente për të marrë zgjidhje përfundimtare të problemit, por deri më sot nuk është marrë asnjë masë konkrete.

Më datë 23.03.2021, kam paraqitur një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ndaj Bashkisë Lezhë. Për këtë kallëzim është regjistruar materiali penal nr. 349/2021 me vendimin e datës 07.04.2021. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

penal. Në vitin 2024, kam ngritur padi ndaj prokurores përkatëse, për shkak të mosveprimit të saj dhe tejkalimit të afateve ligjore për ndjekjen dhe zbatimin e çështjes.

Në nëntor 2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka nxjerrë vendim në favorin tim, duke kërkuar nga Prokuroria marrjen e masave për zbatimin e vendimit dhe trajtimin e çështjes në përputhje me ligjin. Megjithatë, deri më sot, Prokuroria nuk ka dhënë asnjë informacion mbi nisjen e hetimeve ose ndërmarrjen e veprimeve konkrete, pavarësisht se janë tejkualuar afatet ligjore. Kjo zvarritje ka lënë pa zgjidhje një problem që vazhdon të më shkaktojë dëme materiale dhe pengesa serioze në jetën e përditshme. Duke qenë se jam person me aftësi të kufizuara, konsideroj se kjo zvarritje dhe mosveprim institucional përbëjnë një trajtim të padrejtë dhe potencialisht diskriminues ndaj meje.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

1. Konstatim diskriminimi;
2. Shqyrtimi i rastit dhe verifikimi i mënyrës së trajtimit nga Prokuroria;
3. Marrjen e masave të nevojshme për nisjen e hetimeve dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore;
4. Garantimin e trajtimit të barabartë dhe respektimin e të drejtave të mia si person me aftësi të kufizuara.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe

mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

N. T., rezulton se ka paraqitur që nga viti 2008 ankesa pranë institucioneve kompetente për zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga përmytjet e banesës së tij në fshatin Ishull, Lezhë, si pasojë e kanalit kullues mbi të cilin janë kryer ndërtime pa leje që pengojnë rrjedhjen normale të ujërave dhe shkaktojnë dëme materiale dhe pengesa serioze në jetën e përditshme të ankuesit.

Më 23.03.2021, ankuesi ka depozituar kallëzim penal nr. 349/2021 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë kundër Bashkisë Lezhë, për mosveprim dhe zvarritje në trajtimin e çështjes. Me vendimin e datës 07.04.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë vendosi mosfillimin e procedimit penal.

Ankuesi, kundër vendimit të datës 07.04.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka depozituar kërkesën penale nr. 124, dt. 06.06.2024. Kjo kërkesë u pranua dhe më 21.11.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nxori vendimin nr. 124, me të cilin shfuqizoi vendimin e Prokurorisë për mosfillim të procedimit penal dhe urdhëroi Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë për regjistrimin dhe trajtimin e procedimit penal në përputhje me ligjin.

Si pasojë e këtij vendimi, më 27.01.2025 u regjistrua procedimi penal nr. 83 në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ku çështja ndodhet aktualisht në fazën e hetimit dhe nuk është përfunduar.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të ndërmarrë masat e nevojshme për konstatimin e diskriminimit në trajtimin e çështjes së tij, të shqyrtojë rastin dhe të verifikojë mënyrën e trajtimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, si dhe të urdhërojë marrjen e masave konkrete për nisjen e hetimeve dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të lëshuara në favor të tij dhe të garantojë trajtimin e barabartë dhe respektimin e të drejtave të tija si person me aftësi të kufizuara.

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht:

“Neni 277.

1. Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

2. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.

Neni 278.

1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.

2. *Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.*

Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi i vendimeve të organeve gjyqësore si dhe të prokurorisë bëhet sipas hierarkisë, në shkallët më të larta të gjykatave respektive dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 291³, të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të prokurorit, ka përcaktuar se:

“1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura.

4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.

5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 293⁴, të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të prokurorit, ka përcaktuar se: *“1. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit”.*

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përcaktohet se: “Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundërvajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, apo për më tepër

³ Vendimi për mosfillimin e procedimit.

⁴ Referimi i veprës penale te prokurori.

kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Lidhur me pretendimin e ankuesit N. T., se gjatë shqyrtimit të kallëzimit të tij penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë kryer shkelje procedurale dhe mosveprime të paarsyeshme, ankuesi ka të drejtë të drejtohet tek organet kompetente, përfshirë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për hetimin dhe vlerësimin e veprimeve ose mosveprimeve të pretenduara si të paligjshme dhe për marrjen e masave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër, Komisioneri thekson se pretendimet e ankuesit nuk mund të shqyrtohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi ky organ nuk ka juridiksion mbi veprimet e Prokurorisë dhe, për rrjedhojë, ankesa nuk i nënshtrohet procedurave të mëtejshme ligjore, duke ruajtur në këtë mënyrë ndarjen e kompetencave dhe pavarësinë institucionale të organeve të drejtësisë.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”. Mungesa e kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e këtij pretendimi të paraqitur nga ankuesi, e bën ankesën të papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁵.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, z. N. T., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ Për analogji citojmë Vendimet nr. 54, datë 11.04.2023, nr. 203, datë 19.10.2023, nr. 185, datë 24.06.2024, nr.85, datë 14.04.2025 të KMD-së.